

LIGJ
Nr. 110/2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008,
“PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në fund të nënndarjes “ii” të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 122 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Masa e bllokimit të veprimtarisë hiqet para afatit 30-ditor nëse tatimpaguesi paguan dënimin sipas këtij paragrafi;”.

Neni 2

Në kreun XV, pas pikës 5 të nenit “Dispozita kalimtare” shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Pajisjet fiskale, të ofruara nga shoqëritë e autorizuara, me të cilat janë pajisur tatimpaguesit para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vijojnë të funksionojnë dhe të mirëmbahen nga këto shoqëri për aq sa nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”.

Deri në datën e fillimit të efekteve juridike, sipas nenit 48 të ligjit nr. 87/2019, shoqëritë që kanë qenë të autorizuara, sipas vendimit nr.781, datë 14.11.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe iu ka përfunduar afati i autorizimit përpara apo gjatë periudhës kalimtare, vazhdojnë të ofrojnë shërbimin e mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tatimpaguesit. Përcaktimet e këtij paragrafi nuk përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve sipas ligjit nr. 87/2019.”.

Neni 3

Në pikën 3 të nenit 136 fjalët “Nga data e fillimit të zbatimit të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “Në momentin e shfuqizimit të neneve 55 dhe 56 të këtij ligji”.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 29.7.2020.

**Shpallur me dekretin nr. 11584, datë 5.8.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 146, datë 07.08.2020